

# **ASAMBLEJA E ŠTË E PËRGJITHSHME**

## **(E JASHTËZAKONSHME)**

**E**

## **CCI FRANCE - ALBANIE**

**ONLINE**

**(Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Francë-Shqipëri)**

**18 dhjetor 2020**

### **PROCES VERBAL**

-----

#### **1. HYRJA**

Julien ROCHE përshëndet të gjithë pjesëmarrësit dhe hap zyrtarisht Asamblenë e Përgjithshme. Ai raportoi se 28 anëtarë janë të pranishëm sot, kuorumi është arritur dhe prandaj mund të merren vendime. Ai i uron të gjithëve bashkëpunim të frytshëm.

Presidenti Julien Roche fton Blerina Kazhanin, Drejtore Ekzekutive e CCI France Albanie për të shpjeguar vonesën e miratimit të statuteve nga Gjykata dhe të paraqesë aktivitetet 2019-2020 si dhe projektet në zhvillim për 2021.

#### **2. FJALA E MIRËSEARDHJES – PRESIDENTI JULIEN ROCHE**

**Përshëndetje të gjithëve,**

Së pari, mirëseerdhët në këtë Asamble të Përgjithshme të jashtëzakonshme nga disa këndvështrime, së pari, Asamble e përgjithshme e jashtëzakonshme ligjërisht, dhe gjithashtu sepse edhe rrethanat janë të jashtëzakonshme.

Shpresoj se edhe ju bashkë me familjaret tuaj jeni mirë në këto kohë shumë të veçanta.

Me këtë rast, unë do të doja të përshëndes kujtimin e bashkatdhetarit tonë Madjid Ait-Abbas i cili vdiq si rezultat i Covid pavarësisht riatdhesimit të tij urgjent në Francë falë mbështetjes efektive të Ambasadës sonë.

E gjithë kjo është shumë e trishtueshme por jeta vazhdon dhe ne duhet të përballemi me vështirësitë. Shfaqja e afërt e vaksinave më në fund po hap perspektiva shumë pozitive për ne dhe qëllimi tani është të marrim kohën e nevojshme, apriori deri në verën e ardhshme. Ne do t'a arrijmë, jam i sigurt. Solidariteti duhet të luajë midis anëtarëve tanë. Mos hezitoni të na tregoni për vështirësitë tuaja, ne do të bëjmë më të mirën për t'ju ndihmuar.

Po thoja që kjo AP ishte e jashtëzakonshme në më shumë se një mënyrë, në veçanti gjithashtu sepse pavarësisht veprimeve tona të vazhdueshme, dhe në këtë rast përshëndes punën e drejtoreshës sonë Blerina Kazhani, Gjykata e Tiranës ende nuk ka miraturar statutet tona të reja, për mungesë të gjyqtarëve nga një zinxhir te sëmuresh të njëpasnjëshëm që e ka parandaluar këtë miratim deri më sot.

Sapo të marrim validimin nga Gjykata, atëherë ne do të jemi në gjendje të mbajmë një AP të vërtetë me mundesine për të votuar.

Ne do t'ju mbajmë të informuar për këtë çështje.

Është e panevojshme të thuhet që ky vit nuk ka qenë shumë i mirë, por për Dhomën tonë dëmi është ende i kufizuar falë besnikërisë së anëtarëve tanë të cilët kanë qenë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre financiare. Për fat të keq nuk është rasti për të gjithë, veçanërisht për "viktimat" e Covid, kryesisht në fushën e turizmit, por edhe për të tjerët. Ne po konsiderojmë t'u japim atyre një status të veçantë gjatë pandemisë në mënyrë që ata të mos përjashtohen për mungesën e pagesës së detyrimeve të tyre, siç kërkojnë statutet tona.

Pavarësisht të gjitha këtyre vështirësive, ne duhet të nënvizojmë suksesin e ndërmarrjes franceze Voltalia e cila është në proces të anëtarësimit në dhomën tonë dhe e cila, pavarësisht pandemisë, që në gjendje të fitonte thirrjen e madhe për tenderë për parkun fotovoltaik Karavasta në rajonin e Fierit, i cili do të jetë parku më i madh fotovoltaik në Ballkan me një kapacitet prej 140MW.

Shpresojmë se ata do të jenë gjithashtu fituesit shkurtin e ardhshëm për tenderin e dytë të madh në Spitalle, në rajonin e Durrësit, i cili do ta bënte Voltalian një nga prodhuesit më të mëdhenj të energjisë private dhe të pastër në Shqipëri.

Tani ja kaloj fjalën Blerinës

**Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme miraton unanimisht fjalën e presidentit Roche**

## **2. STATUTET – NGA DREJTORESHA EKZEKUTIVE BLERINA KAZHANI**

Drejtoresha informon anëtarët se të gjithë janë informuar me email se statutet e reja janë akoma duke u validuar në gjykatë.

- AP 2019 u mbajt më 02/10/2019. Dokumentet e dhura u përgatitën bashkë me noteren dhe iu dërguan gjykatës. Ne vijim pati disa ngjarje në vendin tonë e jo vetëm:

- 1) Tërmetet në nëntor 2019 dhe gjykatat u mbyllën për 3 javë.
- 2) Procesi i « Vetingut».
- 3) Në mars 2020 për shkak të karantinës nga Covid-19 gjykatat u mbyllën sërish.
- 4) Gjykatësi i parë që merrej me çështjen e CCIFA nuk e kaloi procesin e “Vetingut”.
- 5) U caktua një gjykatës tjetër për çështjen e CCIFA
  - 6) Aktualisht, po presim për datën për seancën e dytë të gjyqit.

Presidenti i pyet pjesëmarrësit nëse kanë ndonjë koment të vecantë në lidhje me statutet, dhe më pas i kërkon Asamblesë miratimin e vonesës së validimit të stauteve të reja.

**Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme miraton unanimitisht vonesën e validimit të statuteve**

### **3. RAPORTI I AKTIVITETIT 2019-2020 DHE PROJEKTET AKTUALE - NGA BLERINA KAZHANI**

Blerina Kazhani, Drejtore Ekzekutive e CCI France Albanie prezantoi raportin e saj mbi aktivitetet dhe projektet në vijim (shih prezantimin bashkëngjitur).

#### **1. Raporti I aktiviteteve 2019**

□ *Aktiviteti ekonomik është ngadalësuar ndjeshëm nga pandemia e COVID-19; ne shpresojme se shumë vende po hapin kufijtë dhe po përpiqen të arrijnë vonesën e krijuar nga kriza shëndetësore. CCIFA vëzhgon mundësitë e reja për anëtarët dhe partnerët tane në botën e biznesit. Ne kemi organizuar evente të ndryshme virtuale me dëshirën t'u ofrojmë anëtarëve tanë mundësi të informohen, të ndajnë praktikatat më të mira dhe të cojnë me tej biznesin e tyre.*

- Prezantim i rregullores së inspektimeve për kompanitë
- Forumi i 3të kombëtar i grave frankofone shqiptare
- Forumi ekonomik studentët dhe shoqëritë në Shqipëri
- Tryezë e rumbullakët: Kompetencat për futjen në tregun e punës
- Koncert piano solo: Pierre-Yves Plat
- Event i << Turizmi Francez në Shqipëri >>
- Drekë-debat me drejtorin ekzekutiv të AIDA-s për investimet e huaja në Shqipëri, Z. Sokol Nano
- 14 Korrik Festa kombëtare
- Fest - Noz à Tirana- edicioni i dytë
- Asambleja e Përgjithshme 2019
- Mbrëmje Degustimi, Champagne Louis Roederer
- Tryezë e rumbullakët mes përfaqësuesve të Dhomave të Tregtisë dhe Zv. Ministres së Financave dhe Ekonomisë
- Numërori i anëtarëve të Dhomave franceze të Tregtisë në të gjithë botën

#### □ **Anëtarë të rinj 2019 :**

1. Truen Sh.p.k - Mrs. Ortenca Hoxha
2. WEnerg Sha - Mrs. Ortenca Hoxha
3. Viaggiare e Sorridere - M. Dritan Gremi

#### 4. Vision Shpk - Mrs. Margarita Lutaj

## **2. Raporti i aktiviteteve 2020**

Webinaire Regard business #1 me Julien Roche, Gasmen Toska, Bledar Shella

- Webinar Food processing - një strategji e mundshme për Europën Qëndrore dhe Lindore | 17/06/2020 |
- Webinaire Regard Business #2 "Procesi i zhvillimit të reformës fiskale – Cfarë duhet të marrin në konsideratë bizneset?" 12/06/2020
- Business Booster Forum - Boostez vos affaires à l'international 24/06/2020
- ViaEgnataia2.0- në bashkëpunim me Ambasadën e Francës, Nëntor
- Rendez-vous b2b d'affaires et d'investissement Paraguay-Europe 2020 22/10/2020 - 8:00 a.
- Webinaire me ekonomistin Nicolas Baverez, 13 tetor, ora 14h00, mbi "Revolucionet zinxhir të Covid-19"
- ❖ Intervista me temë: Ekonomia në Shqipëri pas Covid-19 me anëtarët tanë
  - Shpërndarja e informacioneve mbi anëtarët tanë në rrjetet tona sociale
  - Anketa e anëtarëve mbi ndikimin e krizës
  - Përditësimi i faqes së internetit të Dhomës
  - + 20 letra informuese mbi situatën e krijuar nga Covid-19
  - Zbuloni mundësinë e re që ofron faqja jonë e internetit – Gjeni klientin tuaj

### ❖ ANËTARË TË RINJ 2020

1. A.C.T.I SHPK
2. AUTORITETI PORTUAL DURRES
3. RAFAELO RESORT
4. MELGUSHI SHPK
5. CABINET D'AVOCATS KLIT DELILAJ

**Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme miratoi në unanimitet  
raportin e aktiviteteve 2019-2020**

#### **4. MBYLLJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME - NGA JULIEN**

##### **ROCHE**

Julien ROCHE mbyll Asamblenë e Përgjithshme, falënderon anëtarët për kohën që i kushtojnë CCI France Albanie, për investimin që i kushtohet nga të gjithë aktiviteteteve dhe zhvillimit të Dhomës.

Presidenti ROCHE fton pjesëmarrësit që të marrin pjesë në konferencën ekonomike menjëherë pas Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme.

\* \* \*

\* \* \*

**SITUATA AKTUALE E TREGUT NË SHQIPËRI DHE NË FRANCË**

**18.12.2020, 11:30**

*Konferencë online*

5. **FJALA E SHKËLQESISË SË SAJ AMBASADORJA E FRANCËS NË SHQIPËRI, ZONJA ELISABETH BARSACQ**
  
6. **FJALA E MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES, ZOTI EDUARD SHALSI**
  
7. **FJALA E ZËVENDËS-PRESIDENTIT TË CCI FRANCE-ALBANIE, ZOTI GASMEN TOSKA**
  
8. **FJALA E ZOTIT ALEXANDRE FISCHMAN, KESHILLTAR FINANCIAR – SHERBIMI EKONOMIK RAJONAL**

\* \*